



Public Health  
England

**NHS**

## Një udhëzues për vaksinimin COVID-19

# Të gjitha gratë në moshë riprodhuese, ato që janë aktualisht shtatzënë ose që ushqejnë fëmijë me gji

**Ju duhet ta lexoni këtë para se të shkoni për vaksinim**

Vaksinat COVID-19 të disponueshme në MB, Mbretërinë e Bashkuar janë treguar të efektshme dhe kanë një profil të mirë sigurie. Vaksinat e hershme COVID-19 nuk përmbajnë organizma që mund të shumohen në trup, kështu që ato nuk mund të infektjnë një fëmijë të palindur në bark.

**Shumë vakcina mund të bëhen në mënyrë të sigurt në shtatzëni, prandaj pse po këshillohem kundër kësaj vaksine?**

Vaksinat nuk janë testuar ende në shtatzëni, kështu që derisa të ketë më shumë informacion, ato që janë shtatzënë nuk duhet ta marrin si një procedurë rutinë këtë vaksinë. Kërkohen prova jo-klinike para se të filloj ndonjë studim klinik në shtatzëni, dhe para kësaj, është e zakonshme të mos rekomandohet vaksinimi rutinë gjatë shtatzënisë

Dëshmitë nga studimet jo-klinike të vaksinës Pfizer BioNTech janë marrë

dhe shqyrtuar nga Agjencia Rregullative e Barnave dhe Produkteve Shëndetësore (MHRA). Kjo dëshmi u rishikua gjithashtu nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe organet rregullatore në SH.B.A., Kanada dhe Evropë dhe nuk janë ngritur shqetësime në lidhje me sigurinë në shtatzëni.

Studimet jo-klinike të vaksinës Astra-Zeneca COVID-19 nuk kanë ngritur shqetësime.



**Vaksinimi COVID-19**

Mbroni veten.

Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (JCVI) ka njohur që përfitimet e mundshme të vaksinimit janë veçanërisht të rëndësishme për disa gra shtatzëna. Kjo përfshin ato që janë në rrezik shumë të lartë për të kapur infeksionin ose ato me gjendje klinike që i vënë ato në rrezik të lartë të vuajnë nga ndërlikime serioze nga COVID-19.

Në këto rrethana, ju duhet të diskutoni për vaksinimin me mjekun ose infermieren tuaj dhe mund të mendoni se është më mirë të shkoni përpara dhe të merrni mbrojtjen nga vaksina.



## Ushqyerja me gji

Nuk ka të dhëna për sigurinë e vaksinave COVID-19 në ushqyerjen me gji ose në foshnjën që ushqehet me gji. Pavarësisht kësaj, vaksinat COVID-19 nuk mendohet të jenë një rrezik për foshnjën që ushqehet me gji dhe përfitimet e ushqyerjes me gji janë të njohura. Për shkak të kësaj, JCVI ka rekomanduar që vaksina të merret gjatë ushqyerjes me gji. Kjo është në përputhje me rekomandimet në SHBA dhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

## Çfarë do të thotë kjo për mua?

Këto janë pikat kryesore që duhet të merrni parasysh:

- nëse jeni shtatzënë nuk duhet të vaksinoheni nëse nuk jeni në rrezik të lartë - mund të vaksinoheni pasi të ketë mbaruar shtatzënia
- nëse keni marrë dozën e parë dhe më pas mbeteni shtatzënë duhet të vononi dozën e dytë deri pas mbarimit të shtatzënisë (përveçse nëse jeni në rrezik të lartë)

Nëse jeni shtatzënë por mendoni se jeni në rrezik të lartë, duhet të diskutoni për kryerjen ose përfundimin e vaksinimit me mjekun ose infermieren tuaj. Megjithëse vaksina nuk është testuar në shtatzëni, ju mund të vendosni që rreziqet e njohura nga COVID-19 janë aq të qarta sa dëshironi të vazhdoni me vaksinimin. Nuk ka këshillë për të shmangur shtatzëninë pas vaksinimit COVID-19.

Nëse jeni duke ushqyer me gji, mund të vendosni të prisni derisa të keni mbaruar dhënien e gjirit dhe më pas të bëni vaksinimin.

**Vaksinimi, ndihma në mbrojtjen e atyre më të prekshëm.**